

## **STATUT DHE AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA**

### **GJIKURIA PRO SHPK**

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

#### **Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

#### **Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më 12.12.2023, Une, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin  
**GJIKURIA PRO SHPK**

(2) Themeluesi i shoqërisë eshte: **GJIKURIA SHPK** një shoqeri shqipetare e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NUIS J62903456H e perfaqesuar nga Florenc Gjikuria ne baze te vendimit te asamblese te dates 12.12.2023.

#### **Neni 2:**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Konsulence dhe ndjekje e procedurave te blerjes se mallrave per pale te treta, tregeti mallrash te ndryshme industriale, ndermjetesim. Konsulence per pjesemarrje ne tendera publike e private, hartim dokumentacioni ne te gjitha fazat e prokurimit si dhe ndjekja e proceurave perkatese perfshire edhe fazen e ankimit administrativ dhe gjyqesor; si dhe cdo veprimtari tjeter te lejueshme nga kuadri ligjor dhe rregullator ne fuqi si dhe ne perputhje me praktikat e shendosha te biznesit lokal apo nerkombetar ne per gjithesi.

#### **Neni 3:**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat dhe do te vazhdoje veprimtarine deri ne mbyllje te shoqerise.

#### **Neni 4:**

**Selia**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Njësia Bashkiake Nr. 2, rruga “Faik Konica”, residenca “Lion Park”, kati 3-të, Tiranë, Shqiperi.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [info@gjikuria.al](mailto:info@gjikuria.al)

**Kreu II**  
**Kapitali**

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**



(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Leke (njeqind mije Leke). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku themelues **GJIKURIA SHPK**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 100,000 Leke (njeqind mije Leke) Leke që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

#### **Neni 6: Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### **KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE Neni 8 Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve pér shoqerinë pér çeshtjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve pér personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm pér një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 9** **Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar pér mbledhjen e asamblesë.

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme mund te realizohen edhe nepermjet menyres online, telekonferences, videokonferences, me kushtin qe pjesemarresit te identifikohen.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, pér të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 10** **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 pér qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë pér çeshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet pér shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 11** **Marrja e vendimeve**



Asambleja e përgjithshme vendsos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendsos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### **Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votes**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.


2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### **Neni 13 Administrimi**

Personi i mëposhtëm emerohet si Administrator i shoqërisë me nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje:

Të dhënët e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit: **Betim Gosturani**, lindur me 28.10.1985 ne Bajram Curri, identifikuar me karten e identitetit me nr. personal I51028049C.

Specimen nenshkrimi



#### **Neni 14 Kompetencat e Administratorit/ve**

Administratori/ët ka/në të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

f) Administratori eshte i detyruar te raportoje ne baza ditore tek strukturat perkatese te shoqerise meme ne perputhje me procedurat e leshuara nga kjo e fundit si dhe te operoje ne baze te ketyre procedurave.

Administratorret Jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 15** **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë regjistrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastojt përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdës;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përfjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkejjes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për te vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të

rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftesi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**Kreu IV**  
**Viti finanziar-ekspertet**  
**Neni 16**  
**Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

**Neni 17**  
**Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrolllet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergaqit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrolllet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

**Kreu V**  
**Prishja –riorganizimi i shoqërisë**  
**Neni 18**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;



ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoperi ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti i cili eshte hartuar ne dy gjuhe shqip dhe anglisht, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e Shkalles se Pare Juridikioni i Pergjithshem Tirane.

**ORTAKU**

**GJIKURIA SHPK**

Perfaqesuar nga:

*Florenc Gjikuria*

